


REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, neneve 9 dhe 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Rregullores për varrezat ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave 15Nr.400-71876 e datës 27.11.2018, Rregullores 15Nr.011-15426 e datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave 15Nr.400-71876 e datës 27.11.2018 si dhe nenit 2 paragrafi 4 dhe nenit 13 të Rregullores për ndarjen së subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 31.03.2023, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

## V E N D I M

### **PËR SUBVENCIONIMIN E SHPENZIMEVE PËR SHËRBIMET E VARRIMIT TË QYTETARËVE ME VENDBANIM TË PËRHERSHËM NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT**

- I. Me këtë Vendim **përcaktohet** që shuma për subvencionimin e shërbimeve të Varrimit për qytetarët e Komunës së Lipjanit të jetë **280.00 €** ( dyqind e tetëdhjetë euro) për një varrim.
- II. Autorizohet , Kryetari i Komunës që të lidh Marrëveshje me shkrim me institucionet fetare që veprojnë në territorin e Komunës së Lipjanit për kryerjen e shërbimeve të varrimit, konform dispozitave të këtij Vendimi dhe legjislacionit në fuqi .
- III. Subvencionimi i shpenzimeve për shërbimet e varrimit do të bëhet për çdo person të vdekur për të cilin në bazë të ekzaminimeve mjekësore në pajtim me dispozitat ligjore është konstatuar vdekja. Në shërbimet e varrimit përfshihen : hapja e varrit, fletëlajmërimet (afishet), dërrasat, piramida, pastrimi i kufomës, mbulesa e kufomës dhe qefini.
- IV. Kryetari i Komunës pas pranimit të raportit mbi vdekjet me dokumentacionin e bashkëngjitur nga ana e institucionit fetar nxjerr Vendim për ekzekutimin e pagesës në baza mujore. Në rastet se mund të ndodhin vonesa në lidhjen e Marrëveshjes për shkaqe të ndryshme me ndonjë institucion fetar subvencionimi i qytetarëve të atij institucioni fetar do të bëhet sipas kërkesave individuale, konform faturave të bashkëngjitura dhe dokumentacionit tjetër përkatës deri në shumën e përcaktuar në nenin I të këtij Vendimi.

V. Mjetet financiare për mbulimin e shërbimeve të varrimit do të paguhen nga buxheti i Komunës , kodi i programit 16003, kategoria ekonomike e subvencioneve të planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës dhe do të derdhen në xhirollogaritë e Institucioneve Fetare përgjegjëse për kryerjen e shërbimeve të varrimit. Në rast se brenda vitit përkatës mund të ketë mungesë të mjeteve financiare në kategorinë e subvencioneve të planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës, shërbimet e varrimit mund të paguhen edhe nga kodet tjera programore të kategorisë së subvencioneve , aty ku ka mjete të mjaftueshme.

VI. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa

VII. Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës .

VIII. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400-15449 i datës 17.03.2021 si dhe Marrëveshja e Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan 01-400-01-19079 e datës 13.04.2021.

15 Nr. 400/01-16372

Lipjan, më 31.03.2023

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit  
Daut Azemi

